

**VENDIM**  
**Nr. 1, datë 9.10.2023**

**PËR SHPALLJEN E KANDIDATËVE FITUES PËR ANËTARË GJYQTARË TË  
KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

Në mbështetje të pikës 7, të nenit 17, të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, Komisioni i Votimit, për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, i përbërë nga anëtarët:

Alda Sadiku – kryetare;

Engjëllushe Tahiri – anëtare;

Sonila Hoxha – anëtare,

bazuar në rezultatet e votimit për zgjedhjen e anëtarëve gjyqtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor, sipas procesverbalit bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij,

**VENDOSI:**

1. Të shpallë emrat e kandidatëve fitues për anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si vijon:
  - 1) Emona Muçi shpallet fitues për Gjykatën e Apelit;
  - 2) Gentjana Muçaj shpallet fitues për Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë;
  - 3) Markelian Koça shpallet fitues për Gjykatën e Shkallës së Parë jashtë Tiranës.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankimi në Gjykatën Administrative të Apelit brenda 5 (pesë) ditëve, duke nisur ky afat nga dita e shpalljes së vendimit në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë.
3. Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, si dhe në Fletoren Zyrtare. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONI I VOTIMIT**

**Kryetare: Alda Sadiku**

**Anëtare: Engjëllushe Tahiri, Sonila Hoxha**